



## One Albania SHA

Adresa: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi "Square 21", Tiranë, Shqipëri

Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al

Certifikuar: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 |

NIPT: J61814094W

### ANEKSI NR. 1

#### KUSHTET E VEÇANTA TE SHERBIMEVE DHE TARIFAVE

Në këtë Aneks, pasqyrohen shërbimet bazë dhe shtesë të ofruara nga ONE ALBANIA SHA. dhe të zgjedhura nga Pajtimtari, kushtet e veçanta, tarifet përkatëse të shërbimeve si dhe mënyra e tarifimit.

- Plani Tarifor One Unlimited Student me kontratë

Plani Tarifor	One Unlimited Student
Pajtimi Mujor	1,100 Lekë/Muaj
Minuta Kombëtare	Pa limit
SMS Kombëtare	Pa limit
Internet	25 GB
Internet eLearning	100 GB
Music Streaming	100 GB
Internet me shpejtesi te reduktuar	Pa limit
<b>Tarifat/Minutë (pas konsumimit të njësive falas)</b>	
Minuta drejt të gjitha destinacioneve Kombëtare	39.0000
<b>Tarifat/Sekondë (pas konsumimit të njësive falas)</b>	
Kombëtare	0.6500
<b>Shërbime të tjera</b>	
SMS Kombëtare	10.0000
SMS Ndërkombëtare	15.0000
<b>Tarifat ndërkombëtare/minutë (pas konsumimit të njësive falas)</b>	
Zona 1	81.9900
Zona 2	149.9900
Zona 3	179.9900
Zona 4	269.9900
Zona 5	419.9900
<b>Tarifat ndërkombëtare/sekondë</b>	
Zona 1	0.9998
Zona 2	1.8498
Zona 3	2.0998
Zona 4	3.7998
Zona 5	5.9998

#### SHËNIME TË PËRGJITHSHME

- 1) Të gjitha tarifet e përcaktuara më sipër përfshijnë TVSH-në.
- 2) Politika e përdorimit të drejtë për minutat dhe sms kombëtare është 3,000 minuta dhe 3,000 sms.
- 3) Minutat kombëtare janë të vlefshme drejt të gjithë operatorëve kombëtarë celularë dhe fix.
- 4) SMS kombëtare janë të vlefshme drejt të gjithë destinacioneve kombëtare.
- 5) Benefitet e përfshira në planin tarifor One Student, si Minutat, SMS-te apo GB-internet, janë të vlefshme dhe mund të përdoren për një periudhë kohore të përcaktuar, brenda një muaji kalendarik, dhe nuk mund të transferohen në muajin pasardhës.



## One Albania SHA

Adresa: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi "Square 21", Tiranë, Shqipëri

Phone: +355 42275232 | E-mail: [contactus@one.al](mailto:contactus@one.al)

Certifikuar: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 |

NIPT: J61814094W

- 6) PAGESA FIKSE MUJORE dhe Minutat kombetare për muajin e parë të aktivizimit do të jetë proporcionale në varësi të datës së aktivizimit ndërsa njësitë të përfshira në plan (SMS dhe MB) janë te plota pavarësisht datës së aktivizimit. Ky kusht aplikohet për të gjitha mënyrat e abonimit: Aktivizim i ri, transferim, tjetërsim.
- 7) Koha fillestare e tarifimit të bisedës është 60 sekonda, më pas do të aplikohet tarifimi për sekondë.
- 8) Përlllogaritja e tarifimit të internetit do të bëhet për çdo 10 KB.
- 9) Interneti, pas përfundimit të njërive me shpejtësi maksimale të planit, do të jetë me shpejtësi të reduktuar 128 Kbps.
- 10) Benefitet e planit tarifor përfitohen automatikisht çdo datë 1 (një) të muajit kalendarik, pa pasur nevojë që pajtimtari të kryejë ndonjë veprim.
- 11) Pajtimtari mund të rimbushë numrin në çdo kohë në një nga dyqanet ONE, nëpërmjet aplikacionit My One, ose online nëpërmjet faqes web [www.one.al](http://www.one.al) dhe të aktivizojë një nga paketat me parapagesë. Përfitimet e paketave me parapagesë kanë përparësi konsumi në lidhje me përfitimet e planit tarifor One Student.
- 12) Për pajtimtarin që do të kryejë rimbushje do të jenë të vlefshme të gjitha cmimet standarte në fuqi për klientet me parapagesë. Kjo është e vlefshme si për thirrjet e gjeneruara në Shqipëri ashtu edhe për thirrjet në roaming.
- 13) Afati maksimal i pagesës së tarifës fikse mujore të planit One Student është data 23 e muajit aktual.
- 14) Në faturën e pare do të pasqyrohen detyrimi i muajit paraardhës (proporcional) dhe pagesa fikse mujore e muajit aktual. PAGESAT fikse mujore në vijim do të aplikohen çdo datë 1 të muajit kalendarik. Në faturën mujore të lëshuar, do të shfaqet vetëm vlera e pagesës mujore fikse e muajit aktual.
- 15) Informacioni mbi njësitë e mbetura gjatë muajit përkatës kalendarik mund të merret nëpërmjet aplikacionit My One.
- 16) Kohëzgjatja fillestare, minimale e kontratës është 12 muaj. Në rast të zgjidhjes së parakohshme të kontratës prej Pajtimtarit brenda afatit fillestar 12 mujor apo 24 mujor, Pajtimtari ka detyrim të paguajë si penalitet, tarifata mujore fikse për të gjithë muajt e mbetur deri në përfundimin e afatit të kontratës 12 mujore ose 24 mujore.
- 17) Në rastet kur Pajtimtari ka përfituar një zbritje në çmimin e aparatit të marrë si ofertë specifike, dhe kërkon zgjidhje të parakohshme të kontratës, përveç penalitetit të shënuar me sipër dhe vlerës së plotë korresponduese të ofertës specifike, duhet të paguajë gjithashtu dhe vlerën korresponduese të zbritjes së përfituar në çmimin e aparatit.
- 18) Në rastet kur pajtimtari ka përfituar nga ndonjë ofertë promovionale si psh zbritje në pajtimin mujor, sipas kushteve të ofertës promovionale, dhe vendos të kryejë zgjidhje të parakohshme të kontratës, së bashku me detyrimet e sipërpërmendura duhet të paguajë edhe përfitimet nga oferta promovionale. (shumën e përfitimeve për të gjithë periudhën promovionale).
- 19) Në rast se Pajtimtari do të ndryshojë planin, nga një plan me pagesë fikse mujore më të lartë në një plan me pagesë fikse mujore më të ulët, ka detyrim të paguajë si penalitet, vlerën e diferencës së pagesës fikse mujore për të gjithë muajt e mbetur.
- 20) Në rastet kur Pajtimtari ka përfituar një zbritje në çmimin e aparatit të marrë si ofertë specifike, dhe kërkon të beje ndryshim të planit, nga një plan me pagesë fikse mujore më të lartë në një plan me pagesë fikse mujore më të ulët, ka detyrim të paguajë si penalitet, përveç penalitetit të shënuar me sipër duhet të paguajë gjithashtu dhe vlerën korresponduese të zbritjes së përfituar në çmimin e aparatit.
- 21) ONE Albania ka të drejtë të aplikojë një ndryshim të tarifave të një apo më shumë shërbimeve bazuar në ndryshimin mesatar vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit të publikuar nga Instituti i Statistikave (INSTAT), duke ju referuar treguesit të vitit paraardhës. Operatori ka të drejtë të aplikojë këto ndryshime jo me shume se një herë në vit si dhe jo me vone se 2 muaj pas publikimit të INSTAT.
- 22) Për të mesuar me shume mbi shtetet dhe zonat ndërkombetare klikoni: <https://www.one.al/>

## SHËNIME PËR SHËRBIMIN ROAMING

- 1) Paketat, ofertat dhe koha e bisedës falas që pajtimtari ka përfituar duke aktivizuar ndonjë nga paketat bazë apo ato opsionale, nuk janë të vlefshme dhe nuk mund të konsumohen ndërkohë që klienti përdor shërbimin Roaming, përveç shteteve të Ballkanit Perëndimor.
- 2) Koha fillestare e bisedës për telefonatat hyrëse dhe dalëse në Roaming është 60 sekonda. Pas përfundimit të kohës fillestare gjatë këtij shërbimi do të aplikohet tarifimi për sekondë.
- 3) Interneti në roaming do të tarifohet për çdo 10 KB. Pas përfundimit të MB të përfshira në planin tarifor, do të aplikohen tarifata standarde me parapagesë të vlefshme në Roaming.
- 4) Për të mesuar me shume mbi zonat, shtetet, operatorët, paketat dhe tarifata për njësi për shërbimin Roaming klikoni: <http://smartroam.one.al/>



## One Albania SHA

Adresa: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi "Square 21", Tiranë, Shqipëri

Phone: +355 42275232 | E-mail: [contactus@one.al](mailto:contactus@one.al)

Certifikuar: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 |

NIPT: J61814094W

### SHËNIME TË TJERA PËR ZONËN BALLKANI PERENDIMOR:

- 23) Të gjithë Klientët që i përkasin planit tarifor One Student, të rinj dhe ekzistues të cilët do të vizitojnë Shtetet e Ballkanit Perendimor do të mund të perdorin njesitë e përfshira në programin e tyre (minuta kombëtare, SMS kombëtare, Internet) FALAS sikur të ishin në territorin Shqiptar, duke i zbritur ato nga programi përkatës me konceptin Roam Like at Home (RLAH).
  - i. ONE ka të drejtë të aplikojë Politiken e Përdorimit të Drejtë të Shërbimit të të Dhënave në Roaming sipas Rregullores së AKEP, specifikuar më sipër.
  - ii. Maksimumi i vëllimit të Internetit i cili është i vlefshëm edhe në Roaming në Ballkanin Perendimor: 3.25 GB
  - iii. Pas konsumit të njësive data internet të lejuara në programin përkatës, ONE do të aplikojë një tarifë shtese prej 1.14 leke/MB.
- 5) Telefonata dhe SMS Dalëse Kombëtare quhen të gjitha thirrjet e gjeneruara nga shtetet e Ballkanit Perendimor dhe të terminuara në operatorët celularë të shteteve të Ballkanit Perendimor dhe të Shqipërisë. Destinacionet e tjera do të tarifohen sipas tarifave standarde me parapagesë të vlefshme në Roaming Zona 1.
- 24) Thirrjet hyrëse prej operatorëve celularë të Ballkanit Perendimor dhe Shqipërisë janë FALAS.
- 25) Të gjitha SMS hyrëse janë FALAS.
- 26) Tarifimi i minutave dalese do të kryhet fillimisht për 60 sekondat e para dhe më pas do të vazhdojë për çdo sekondë.
- 27) Tarifimi i minutave hyrëse do të kryhet fillimisht për 30 sekondat e para dhe më pas do të vazhdojë për çdo sekondë.
- 28) Interneti do të tarifohet për çdo 10 KB.
- 29) Shteti i Kosovës, Bosnie Hercegovines, Mali i zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia do të vazhdojë të jetë të përfshirë tek paketat aktuale të vlefshme në Roaming dhe do të vazhdojnë të ofrohen në treg si një alternative shumë e mirë për klientët me kontratë. (të gjitha rrjetet janë të përfshira në këto paketa). Në këto raste, njesitë të përfshira në program me konceptin RLAH do të kenë prioritet mbi paketat Roaming.
- 30) Për të mesuar me shume mbi tarifën e Roaming në shtetet e Ballkanit Perendimore, klikoni: <https://www.one.al/ballkani-roaming/>

Pajtimtari deklaron se ka lexuar dhe është plotësisht në dijeni të Kushteve të Përgjithshme të dhënies së shërbimeve të telefonisë publike të lëvizshme për Pajtimtarin, të cilat janë pasqyruar dhe mund të aksesohen në link-un e mëposhtëm:

<https://www.one.al/kompania/kushtet-e-pergjithshme-te-ofrimit-te-sherbimeve/>

Pajtimtari deklaron se i ka pranuar pa rezerva dhe nën vullnetin e tij të lirë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Pajtimtarit.

Këto Kushte të Përgjithshme së bashku me Kushtet e Veçanta të Shërbimeve dhe Tarifave në fuqi, përbëjnë tërësinë e marrëveshjes ndërmjet palëve për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacioneve prej ONE dhe faturimin përkatës të Pajtimtarit.